



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:095407
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05708707

K.Dh.Sh.II.nr.1231/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Arbor Group”, Sh.p.k, me numër unik identifikues 810198277, me seli në fshatin Koretinë Komuna e Kamenicës, me përfaqësues G.B., kundër debitorit Komuna e Kamenicës, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykata Komerçiale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1529/22 të datës 30.06.2023, me datë 20.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e debitori Komuna e Kamenicës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerçiale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1529/22 të datës 30.06.2023 **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerçiale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1529/22 të datës 30.06.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Kamenicës, kundër urdhrit përmbartimor P.nr.343/22, të datës 19.04.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim M. Musa me seli në Gjilan dhe mbetet në fuqi i njëjti urdhër për përmbartim.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesë, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi ankimuar, dhe të përfundohet urdhëri përmbartimore.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtruar kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitori është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Arbor Group”, Sh.p.k, me datën 19.04.2022 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit Komuna e Kamenicës, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës për shumën e borxhit prej 137,784.00 €.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Arbor Group”, Sh.p.k, me seli në Mitrovicë, me datë 19.04.2022, ka lëshuar Urdhrin përmbartimor P.nr.343/22 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve: faturë nr.5/2022 e datës 01.03.2022 dhe faturë nr.6/2022 e datës 01.03.2022, duke detyruar debitorin që në emër të borxhit për kryerjen e katër situacioneve sipas kontratës KM 653-19-7914-5-1-1 t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 137,784.00 EUR (njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëdhjetë e katër euro), me kamatë ligjore prej 8% nga dita e lejimit deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore. Debitori ka paraqitur prapësim duke kontestuar urdhrin e lejuar për përmbartim me arsyetimin se fatura nr. 5/2022 e dt.01.03.2022 dhe fatura nr.6/2022 e dt.01.03.2022 në bazë të cilave është iniciuar procedura përmbartimore nuk janë dorëzuar fare dhe nuk janë pranuar nga debitori sepse të njëjtat nuk mbajnë vulën e protokollit të debitorit si institucion. Ka shtuar se debitori asnjëherë nuk është njoftuar me këtë faturë por shihet se vetëm është vulosur nga kreditori në mënyrë të njëanshme, pra faturat nuk përmbajnë të gjitha elementet e nevojshme të një dokumenti të besueshëm për iniciimin e procedurës përmbartimore. Po ashtu

ka theksuar se Kontrata e Prokurimit nr.KM653-19-7914-5-1-1 dhe nr. të brendshëm KM653-19-044-511, e paraqitur si provë me të cilën është iniciuar procedura përbarimore nuk përbën dokument përbarimor sipas nenit 22 të LPP-së sepse e njëjta nuk përmban klauzolën e përbarueshmërisë dhe nuk është e ekzekutueshme. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të aprovohet në tërësi si bazuar dhe të shfuqizohet urdhri për lejimin e përbarimit.

Kreditore në përgjigjen në prapësim ka theksuar se procedurën përbarimore e ka iniciuar në bazë të faturave të cilat i plotësojnë kushtet ligjore sipas ligjit të procedurës përbarimore, ku faturat janë origjinale të nënshkruara dhe i përmbajnë të gjitha elementet që duhet ti ketë një faturë sipas ligjit. Ka shtuar se debitori nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e tij siç është paraparë me nenin 69 par.4 të LPP-së andaj edhe nuk janë përmbushur kushtet për anulimin e urdhrin përbarimor. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim: Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Gjykata e shkallës së parë në rastin konkret vlerëson se fatura nr.5/2022 e datës 01.03.2022 në shumë prej 10,574.20 € dhe fatura nr.6/2022 e datës 01.03.2022, në shumën prej 127,209.80€, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, kjo pasi që në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditore dhe debitori, janë

të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe faturat janë pranuar nga debitori përmes vulës së pranimit dhe protokollimit.

Ndër të tjera gjykata e shkallës së parë gjeti se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi burojnë nga kontrata e prokurimit KM 653-19-7914-5-1-1, me nr. të brendshëm KM653-19-044-511 e datës 23.06.2020, ndërsa nga raportet e mbikëqyrësit dhe menaxherit të kontratës të hartuara me datë 15.07.2021 dhe datë 01.03.2022 rezulton se punët për të cilat është kontraktuar kreditori sipas kontratës së lartcekur dhe për të cilat janë lëshuar faturat objekt i këtij përmbarimi janë përfunduar konform kushteve të caktuara, e rrjedhimisht pagesat si në faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi janë bërë të arritshme. Me rastin e vendosjes gjykata vlerësoj pretendimin e debitorit lidhur me pagesën e detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë, debitori ka lidhur Memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, por që nga shkresat e lëndës dhe atë nga kontrata KM 653-19-7914-5-1-1, me nr. të brendshëm KM653-19-044-511 si palë ndërgjyqëse figurojnë debitori dhe kreditori, ndërsa me vet pranimin e faturave që burojnë nga kjo kontratë nga debitori, rezulton se debitori është njoftuar me detyrimin që rrjedh nga këto fatura dhe të njëjtat nuk i ka kundërshtuar deri në iniciimin e kësaj procedure përmbarimore.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe shkalla e dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes për refuzimin e prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë

drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se fatura e lëshuar nga ana e kreditorit përmban nënshkrim nga pranimi dhe protokollimi i debitorit, dhe përcakton kohën e përmbushjes. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga neni 29 i LPP, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Ndërsa sipas nenit 37 të LPP-së përcakton :*“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, gjithashtu sipas nenit 40 të njëjtit ligj citon se : *“Propozimi për përmbardim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë: kërkesën përmbardimore nga paragrafi 1. i nenit 38 të këtij ligji; kërkesën që organi përmbardues ta detyrojë debitorin e përmbardimit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, kurse në kontestet nga raportet ku ekziston kambiali dhe çeku brenda afatit prej tre (3) ditësh, nga dita në të cilën i dorëzohet aktvendimi ta përmbushë detyrimin bashkë me shpenzimet e caktuara; origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm“*. Me çka e mbështet aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë si të drejt.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo gjykatë vlerëson se dhoma e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbardimore, respektivisht është lejuar përmbardimi i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t’i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret fatura nr.5/2022 e datës 01.03.2022 në shumë prej 10,574.20 € dhe fatura nr.6/2022 e datës 01.03.2022, në shumën prej 137,784.00€, janë fatura të pranuar nga debitori përmes vulës së pranimi dhe protokollimit. Po ashtu shkalla e dytë thekson se këto fatura burojnë nga kontrata e prokurimit KM 653-19-7914-5-1-1, me nr. të brendshëm KM653-19-044-511 e datës 23.06.2020, ndërsa nga raportet e mbikëqyrësit dhe menaxherit të kontratës të hartuara me datë 15.07.2021 dhe datë 01.03.2022 rezulton se punët për të cilat është kontraktuar kreditori sipas kontratës së lartcekur dhe për të cilat janë lëshuar faturat objekt i këtij përmbardimi janë përfunduar konform kushteve të caktuara, e rrjedhimisht pagesat si në faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbardimi janë bërë të arritshme. Megjithatë, gjykata sqaron se dëshmohet saktë përmes faturës origjinale që është prezent nënshkrimi i debitorit, duke pranuar faturën në mënyrë të rregullt dhe detyrimin ku është vula e protokollimi të pranuar nga debitori, duke paraqitur bazë të dokumentit përmbardimor për lejimin e përmbardimit në kuptim të nenit 29, 37 dhe 40 të LPP-së.

Andaj, gjykata thekson se me plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm mund ta ketë fuqinë e titullit përmbarues sepse rezulton se debitori e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Një veprim i tillë, për Gjykatën paraqet pranim të faturës dhe detyrimit.

Dhoma e shkallës së dytë vlerësoj pretendimet ankimore lidhur me at se debitori ka pas të lidhur memorandum bashkëpunimi me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor me datën 12.09.2019 me anë të cilit janë dakorduar që projektin për “Rregullimin e shtratit të degraduar të lumit Desivojçë” ta bashkfinancoi deri në realizimin në tërësi të këtij projekti si dhe janë përcaktuar kushtet si në përmbatje të këtij memorandum, dhe se Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor me datën 29.11.2022 ka bërë pagesën e faturës numër 6/22 e datës 01.03.2022 në vlerë prej 127,209.00 euro si dhe me datë 07.12.2022 ka bërë edhe pagesën e faturës me numër 5/22 në vlerë prej 10,574.19 e që në shumë të përgjithëshme prej 137,784.00euro, por një pretendim të till e refuzoj si të pa bazuar për shkak se debitori nuk i ka bashkangjitur transaksionet bankare apo ndonjë provë tjetër me të cilët do të vërtetonin se mjetet e lejuar nga Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor janë bartur tek kreditori pasi që në këto urdhërpagesë të lëshuar nga Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor rezulton se vetëm janë aprovuar pagesa e faturave në fjalë, por jo që janë ekzekutuar ato mjete.

Andaj, duke marr parasysh edhe pretendime të tjera ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e shkallës së dytë
K.Dh.Shk.II.nr.1231/23 dt. 20.05.2024

Gjyqtarja
Franciska Zhitija Ymeri